



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.29, datë 26.03.2026

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR
SHTETASIN ALBERT BRAÇAJ”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 26.03.2026, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “ Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Vendim me nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasin Albert Braçaj,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shtetasin Albert Braçaj .
2. Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602,zëri shpenzime operative administrate, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

Vendimi u miratua me 12 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ**

